

Në kujtim të Ali Podrimës dhe të nismës së Fahredin Shehut **Marc Delouze**

Në hollin e aeroportit ndërkombëtar “Adem Jashari” të Prishtinës, Petriti më thotë: Perandorët romakë Diocletien, Julien, Probus, Claudius Probus, Konstantini i Madh dhe Justiniani ishin shqiptarë, perandori bizantin Anastase I ishte shqiptar, Papa Clement XI ishte shqiptar, vezirët e Mëdhenj që qeverisnin Perandorinë Osmane të shekullit XVII ishin shqiptarë, Mehmet Isa, arkitekti i Taj Mahal në Indi ishte shqiptar, themeluesi i dinastisë së fundit egjiptiane Mehmet Ali Pasha ishte shqiptar (mbreti Faruk që u përmbys nga Naseri në vitin 1952, ishte pasardhës i drejtpërdrejtë i tij).

Ndërkohë që Petriti flet, unë vështroj përmes dritares së xhamtë të aeroportit ushtarakët që shkojnë e vijnë, mesa duket sllovenë rreth atyre makinave të vendosura përgjatë trotuarit me siglën e KFOR në portat e tyre, të Forcave të Kosovës dhe forcat e armatosura të NATO-s, pasi këtu shqiptarët duheshin veçuar nga serbët, duke i bombarduar këta të fundit, meqë ushtria dhe milicia e tyre kishin bërë masakra në mirëbesim të kombeve, të sigurt në të drejtat e tyre territorial: por kjo është e njohur për ne.

(Kush nuk e ka njohur këtë?)

Petriti vazhdon:

... Sadefqar Mehmeti arkitekti i Xhamisë Blu të Stambollit ishte shqiptar, Nënë Tereza apo ndryshe Agnes Gonxhe Bojaxhi, ishte shqiptare, Antonio Gramshi, teoricieni i madh dhe sekretari i Përgjithshëm i Partisë Komuniste italiane ishte nga një familje me origjinë shqiptare, “Blues Brothers” John Belushi, ishte biri i një emigranti shqiptar, balerini dhe koreografi Angjelin Preljocaj është me origjinë shqiptare.

Petriti flet rreth shqiptarëve me bindjen e një zbuluesi të një qytetërimi të vjetër dhe ndërkohë që ai flet, mua më kujtohen ato udhëtime e qëndrime midis popujve me gjuhë aq të aq të mbyllur në kufij të zvogëluar, armenianë, hungarezë, kurdë: të gjithë në mënyrën e tyre kërkonin të vinin në pah kontributin e tyre unikal dhe ndonjëherë origjinal në historinë e botës, si përmes ngjarjeve që kanë ndryshuar historinë e botës apo dhe përmes figurave të mëdha që kanë qenë, janë ende apo do të jenë të mëdhenjtë e kësaj bote. Kështu, (duke pirë gotën e dytë të birrës), Petriti më shpjegon se dy nga këndet që formojnë yllin e Davidit janë simbole shumë të vjetra shqiptare, madje dhe svastika. Padyshim, Moisiu, Jezuja dhe disa të tjerë nuk i detyrohen veç ardhjes së dikujt për t’i shpëtuar teorisë së origjinës shqiptare.

Vend bredharak në detin e historisë, në kërkimin e dëshpëruar të një pikëlidhje antike, ashtu si ëndrrat dhe kushmaret që janë ishuj të humbur në mes të gjumit.

Ushtarët hyjnë në aeroport, të tjerë dalin, pa armë, sikur vijnë për pushime(dhe them) qielli jashtë është blu si në një kartëpostale mesdhetare. Këtu serbët janë të mirëpritur, pohon Petriti në “mercedesin” e tij luksoz që e nget i shpenguar, - ne jemi njerëz mikpritës dhe të këndshëm, ata janë nacionalistë. Por unë nuk i them dhe ruhem t’i pohoj se majin e kaluar isha në Beograd dhe se nuk shoh ndryshime mes popujve për sa i përket mirësjelljes dhe mikpritjes, se vetëm Historia është ajo që më kujton se çdo popull ka ditur të demonstrojë dhe kësaj radhë pa asnjë lloj kundërshtimi, aftësitë e tyre për masakra dhe agresivitet. Në vend që të më pyesin për meritat apo papërshtatshmërive, krahasuar mes nacionalizmit serb apo nacionalizmit shqiptar, në bllokun tim të shënimeve shënoj këtë frazë të Michaux që shpesh më vjen ndër mend dhe që thotë pak a shumë se Çdo popull duhet të ketë turp të ketë histori.

Petriti pohon se shqiptarët kanë qenë gjithnjë në këto troje, se në këtë vend kanë

zhvilluar një qytetërim të lartë (duke u mësuar osmanëve artin e kuzhinës dhe të këngës) ndërkohë që sllavët që vinin nga veriu ishin në këtë kohë gjysmë të egër.

Historia është si një natë e gjatë stuhish detare ku çdo njeri përpiqet të notojë mbi ujë me ndjesinë therëse e të pabesueshme të dëshpërimit, në të cilën do lundrojnë larg e shumë larg dallgë dhe të brishtë

(të paarritshëm?)

ishuj të vëllazërimit.

Kosova pa det dhe pa oqean do ishte megjithatë një ishull, brigjet e të cilit janë rrahur nga gjuhë armike me njëra-tjetrën: gjuhë sharjesh të hedhura mbi të, fjalë përbuzëse, plagosësh, tallëse (kur u ktheva nga ky vend më kujtojnë se në kolezhet e Francës në fundin e shekullit të kaluar, «kosovar» ishte një sharje e madhe që dëgjohej nga nxënësit që nuk e njihnin historinë dhe gjeografinë.

Petriti flet, flet dhe unë vështroj rrugën, fushat, rripat e tokës ngjyrë kafe, të verdhë, këtë «patchwork» në ngjyrë okër që duket nga avioni dhe nganjëherë maja e hollë e një minareje që drejton tehun e vet drejt qiellit bosh si në një përgjumje pa ëndrra. Mendoj për Ali Podrimën, atë burrë të shkurtër dhe njëherësh poet të madh, që erdhi të vdiste në atë qytezë të madhe në jug të Francës (ku e kisha ftuar)

mënyrat e vdekjes janë të ndryshme njëri vdes e tjetri ngordh.

Dallimi është se nganjëherë cofin

dallimi është se nganjëherë cofëtina

jeton më gjatë në kujtesë

ruajuni pranisë së saj

në fund të fundit më mirë

në zgjidhni vdekjen tuaj

Guximi shpërblehet me përjetësi për të cilin kam shkruar një Requiem që dëshiroj ta interpretoj në këtë qytet të vogël të Rahovecit, ku kësaj radhe jam unë ai që jam ftuar si një i pranishëm që mbart në vetvete gjatë gjithë kësaj kohe (tre vjet kanë kaluar tashmë nën urën e supeve tanë të lodhur). Është disi sikur t'i vija për vizitë një pjese të largët të familjes time, ku edhe pse nuk njoh askënd, unë gjej një ndjesi familjare: në një vend të huaj ajo që ne na dallon është pikërisht ajo që na bashkon. Ne të gjithë jemi të njëjlojtë në veçantitë tona. Dhe avulli i bardhë që del nga kazani gjigant dhe i betontë i një centrali bërthamor nuk do më përgënjeshtrojë.

Sa më shumë hyjmë në këtë peizazh, aq më shumë pikëtakojmë dëshmi të asaj ç'ka ishte një luftë e vërtetë. Në buzë të rrugës, nga larg, një kurorë, apo dy, tri, të kapura skiç në një shtyllë druri: diku një buqetë lulesh në një vazo, apo dy-tri, të vendosura në formë rrethore apo katrore, rreth një mungese, një kujtesë e ngjashme. Nganjëherë një pllakë mermeri të zi, një stelë e veçantë e personale, apo një gur varri i ngritur ku duket një emër, dy data tmerrësisht të afërta, një fotografi. Nganjëherë një pankartë më e madhe se të tjerat, një homazh kolektiv për atë që mund t'i ngjasojë një masakre që ka ndodhur. Ndonjëherë, një monument i vërtetë, në këtë rast në qytete apo fshatra, gjithnjë me atë mermer të zi, gjurmët e të cilit nuk i gjen rreth e rrotull. Dhe shtëpitë gjithashtu, të gjitha ose pothuajse në ndërtim e sipër, ngritur me tulla të kuqe, çka çdo fshat e tregojnë si një lloj kantieri, ku përpara kanë grumbuj trungjesh të mëdhenj.

(a po afron dimri? - jashtë bën 30 gradë celsius nga mëngjesi në mbrëmje!).

Vend tullash, trungjesh.

Dhe vdekje.

Por jo trishtim

(buzëqeshjet dhe përkujdesjet e mëdha këtu janë të zakonëshme)

Rahavec.

30.000 banorë

1800 të vdekur.

njerëzit pa atdhe

i vret gjithkush

nuk i duhen kujt

njerëzit pa atdhe

copë toke duan qiell

hiç më shumë

dekën ta bëjnë diku

udhëve tek i harron Zoti

t'i mbulojnë e muranat

korbat t'ua trembin

Kaloj në këmbë përmes qytetit. Kaloj mes një fshati të madh. Ende tulla dhe trungje.

Vajzat dhe djemtë dalin nga shkolla fillore e rajonit parisian. Ah, sikur të mos ishte ngado aroma e specave. Gazi shurdhues i tre motorëve më kalojnë tepër afër! Që nga porta e hapur e një berberi një buzëqeshje të madhe më përshëndet, pacienti i zhytur në karrigen e tij më shoqëron me një tundje koke. Në çdo pyetje që ti benë, të sqarojnë me nxitim.

Ankth i të braktisurve? Në kafenenë e madhe në tarracën e Park Hotel Plaza, kamerieri vegjetarian më shtrëngon dorën përzemërsisht me një mirëkuptim të heshtur. Birra e vendit, (Peja, 1 euro) është e këndshme në qiellzën time të vetmuar, ndërkohë që nata bie mbi çadrat e diellit. Jemi aq pak klientë, humbur në rreth dyzetë tavolina, saqë curili i shatërvanit në mes mbush ndërkohë hapësirën me murmurimën e tij të herëpashershme. Pres grupin e vogël të poetëve që si dhe unë janë të ftuar në këtë festival të parë ndërkombëtar të poezisë.

Blloku im i shënimeve bluan frutat e padurimit tim të pastë ...

Fjalët që ecnin mbi det

një ditë nuk prekën më tokë

humbën në det dhe që atëherë

atje në fund

pushojnë

si vegla të ndryshkur e të vjetër

janë kujtesa e fshehur e shtretërve tanë

ku digjeshin ëndrrat tona të pamundura.

(ah, deti është vdekja e mërmëritur njëmijë herë)

dhe që atëherë

ata presin

fjalët

që batica e ujërave nxjerr si avull

për të gjetur më në fund kuptimin e vjetër

dhe për të shndritur në shkëlqimin e koralit të agimeve

në fletën e pastërtë të një heshtje kripe

Hyjmë në xhaminë e madhe si në një sallon të veçantë. Për mirësjellje por dhe për respekt, heqim këpucët. Një ngrohje elektrike në cep të hyrjes. Ballë «mihrab»-it, një pendul i madh, i vjetër prej bakri që tundet e vret me përtesë kohën në çdo rrahje të

rëndë të tij.

E vjetër prej pesë shekujsh, mbrojtja e xhamisë që nga vitet '70 sigurohet nga qeveria. Përgjegjësi i saj na ul rreth e rrotull pranë tij: na shërbehet rrush dhe çaj me shumicë. Një mësim i vogël sufizmi... Tre shekuj e gjysmë më parë një i krishterë u ftua në një ceremoni syneti. (në xhepin e tij bie zilja e telefonit).

Duke falënderuar, ai i dhuroi sektit sufi një shandan metali me krahë.

(ai e mban në duart e tij të holla e të bukura, sikur të ishte një amator kureshtar në pazarin e gjërave të vjetra) Gjatë luftës, dhe kjo duhej të kishte ndodhur në vitin 1998, ushtria serbe e pushtoi këtë vend ku ishin strehuar dhjetëra banorë. Ata kërkonin "Shandanin e Artë". "Ja ku është, - u kishte thënë miku që na priti, - është prej një metali të rëndomtë, por vlera e tij është tepër e çmuar për zemrat tona.

Pastaj ata na servilen çaj dhe fruta. «Meqë jam mes jush, do të thotë se mbeta gjallë», tha ai. Një buzëqeshje e lehtë u dallua nën mustaqen e tij gjysmë të zbardhur.

Por ja, lutja e xhamisë na bën të çohemi. Askush nuk lutet në sallën e madhe të pushtuar nga zhurmat nervoze të aparateve fotografikë numerikë.

Gjatë qëndrimit tim nuk pashë veç një grua në moshë mesatare që mbante një shami e cila ishte e shoqëruar nga një burrë që kishte në kokë një qeleshe të bardhë tradicionale në formën e një bombe. Disa qindra metra nga xhamia, gjejmë freskinë shpëtimtare të një qilari gjigant me verë: «Stone Castle». Një nga tri më të mëdhatë e Evropës, të thonë këtu. Vera kabërnë, e kuqe dhe e bardhë, shoqërohet me plot copa djathi nga qumështi i deles dhe «jambon»i thatë dhe i prerë hollë. Islami këtu ka një shpirt mjaft të gëzueshëm e miqësor.

Shkojmë kështu gjithnjë e më thellë në burimin e pikëtakimeve tona. Në burimin e lumit Drin. Ujërat e pastra kristal që vijnë nga një rënie e njëpasnjëshme midis gurëve dhe pemëve, na zbulojnë origjinën e tij në misterin e ndrojtur të atij gjelbërimi. Nuk ka një burim të vetëm por një sërë rrjedhash të vogla që shfaqen nga nëntoka. Çdo lum këtu është një pikëtakim i një pafundësie rrjedhjesh nëntokësore. Unë jam një lumë i vetëm - në imazhin e gjithë lumenjve. Meqë në këmbët e mia uji i rrjedhshëm sjell lloj-lloj mbeturinash (në pjesën më të madhe shishe plastike) rreth meje pikas shumë gjëra të pista. Duke vazhduar fjalën nganjëherë lodhem në përpjekjen për një pastrim më të madh. Sigurisht, deti është larg. Por deti po afrohet.

Ulur mbi një shkëmb, me lapsin në dorë, unë ngadalësoj kohën që rreh brenda arterieve të mia.

Nëse ti kërkon detin

këtu në këtë vend

t'i nuk do ta gjesh në gjeografi

por në reflekset gri-blu të syve të burrave dhe grave

në rrjedhshmërinë e dritës së mëngjesit

në dallgëzimin origjinal të kodrinave

në valëzimin e gjelbërt të vreshtave

dhe në vërtitjen sufi ikur nga oborret e padukshme

(Pikërisht në botën e imagjinare deti krijon horizontet e tij)

Nëse t'i kërkon detin

këtu

në këtë vend

ti s' do ta gjesh te kujtesa

ajo ka ikur një ditë dhune dhe vrasje

për të mos lënë në faqen e tokës së trishtuar  
veç firmën e zbehtë me kripën e lotëve të tij.  
Rahovec (Kosovë) - Fecamp (Francë), shtator 2015

*\*Nga gjuha frëngjishte e përktheu, Luan Rama, ambasadori i Shqipërisë në Francë*

Marc Delouze

Mbi një ishull që quhet Kosova

*Në kujtim të Ali Podrimës*

*dhe të nismës së Fahredin Shehut*

Në hollin e aeroportit ndërkombëtar “Adem Jashari” të Prishtinës, Petriti më thotë:

Perandorët romakë Diocletien, Julien, Probus, Claudius Probus, Konstantini i Madh dhe Justiniani ishin shqiptarë, perandori bizantin Anastase I ishte shqiptar, papa Clement XI ishte shqiptar, vezirët e Mëdhenj që qeverisnin Perandorinë Osmane të shekullit XVII ishin shqiptarë, Mehmet Isa, arkitekti i Taj Mahal në Indi ishte shqiptar, themeluesi i dinastisë së fundit egjiptiane Mehmet Ali Pasha ishte shqiptar (mbreti Faruk që u përmbys nga Naseri në vitin 1952, ishte pasardhës i drejtpërdrejtë i tij).

Ndërkohë që Petriti flet, unë vështroj përmes dritares së xhamtë të aeroportit ushtarakët që shkojnë e vijnë, mesa duket sllovenë rreth atyre makinave të vendosura përgjatë trotuarit me siglën e KFOR në portat e tyre, të Forcave të Kosovës dhe forcat e armatosura të Nato-s, pasi këtu shqiptarët duheshin veçuar nga serbët, duke i bombarduar këta të fundit, meqë ushtria dhe milicia e tyre kishin bërë masakra në mirëbesim të kombeve, të sigurtë në të drejtat e tyre territorial: por kjo është e njohur për ne.

(Kush nuk e ka njohur këtë?)

Petriti vazhdon:

... Sadeqar Mehmeti arkitekti i Xhamisë Blu të Stambollit ishte shqiptar, Nënë Tereza apo ndryshe Agnes Gonxhe Bojaxhi, ishte shqiptare, Antonio Gramshi, teoricieni i madh dhe sekretari i Përgjithshëm i Partisë Komuniste italiane ishte nga një familje me origjinë shqiptare, “Blues Brothers” John Belushi, ishte biri i një emigranti shqiptar, balerini dhe koreografi Angjelin Preljocaj është me origjinë shqiptare.

Petriti flet rreth shqiptarëve me bindjen e një zbuluesi të një qytetërimi të vjetër dhe ndërkohë që ai flet, mua më kujtohen ato udhëtime e qëndrime midis popujve me gjuhë aq të aq të mbyllur në kufij të zvogëluar, armenianë, hungarezë, kurdë: të gjithë në mënyrën e tyre kërkonin të vinin në pah kontributin e tyre unikal dhe ndonjëherë origjinal në historinë e botës, si përmes ngjarjeve që kanë ndryshuar historinë e botës apo dhe përmes figurave të mëdha që kanë qënë, janë ende apo do të jenë të mëdhenjtë e kësaj bote. Kështu, (duke pirë gotën e dytë të birrës), Petriti më shpjegon se dy nga këndet që formojnë yllin e Davidit janë simbole shumë të vjetra shqiptare, madje dhe svastika. Padyshim, Moisiu, Jezuja dhe disa të tjerë nuk i detyrohen veç ardhjes së dikujt për t’i shpëtuar teorisë së origjinës shqiptare.

Vend bredharak në detin e historisë, në kërkimin e dëshpëruar të një pikëlidhje antike, ashtu si ëndërrat dhe kushmaret që janë ishuj të humbur në mes të gjumit.

Ushtarët hyjnë në aeroport, të tjerë dalin, pa armë, sikur vijnë për pushime(dhe them) qielli jashtë është blu si në një kartpostale mesdhetare. Këtu serbët janë të mirëpritur, pohon Petriti në “mercedesin” e tij lluksoz që e nget i shpenguar, - ne jemi njerëz mikpritës dhe të këndshëm, ata janë nacionalistë. Por unë nuk i them

dhe ruhem t'i pohoj se majin e kaluar isha në Beograd dhe se nuk shoh ndryshime mes popujve përsa i përket mirësjelljes dhe mikpritjes, se vetëm Historia është ajo që më kujton se çdo popull ka ditur të demostrojë dhe kësaj rradhe pa asnjë lloj kundërshtimi, aftësitë e tyre për masakra dhe agresivitet. Në vend që të më pyesin për meritat apo papërshtatshmërive, krahasuar mes nacionalizmit serb apo nacionalizmit shqiptar, në bllokun tim të shënimeve shënoj këtë frazë të Michaux që shpesh më vjen ndër mend dhe që thotë pak a shumë se *Çdo popull duhet të ketë turp të ketë histori.*

Petriti pohon se shqiptarët kanë qenë gjithnjë në këto troje, se në këtë vend kanë zhvilluar një qytetërim të lartë (duke u mësuar osmanëve artin e guzhinës dhe të këngës) ndërkohë që sllavët që vinin nga veriu ishin në këtë kohë gjysmë të egër.

Historia është si një natë e gjatë stuhish detare ku çdo njeri përpiqet të notojë mbi ujë me ndjesinë therrëse e të pabesueshme të dëshpërimit, në të cilën do lundrojnë larg e shumë larg dallgë dhe të brishtë (të paarritshëm?)

ishuj të vëllazërimit.

Kosova pa det dhe pa oqean do ishte megjithatë një ishull, brigjet e të cilit janë rrahur nga gjuhë armike me njëra-tjetrën: gjuhë sharjesh të hedhura mbi të, fjalë përbuzëse, plagosëse, tallëse (kur u ktheva nga ky vend më kujtojnë se në kolezhet e Francës në fundin e shekullit të kaluar, «kosovar» ishte një sharje e madhe që dëgjohej nga nxënësit që nuk e njihnin historinë dhe gjeografinë.

Petriti flet, flet dhe unë vështroj rrugën, fushat, rripat e tokës ngjyrë kafe, të verdhë, këtë «patchwork» në ngjyrë okër që duket nga avioni dhe nganjëherë maja e hollë e një minareje që drejton tehun e vet drejt



qiellit bosh si në një përgjumje pa ëndërra. Mendoj për Ali Podrimen,  
atë burrë të shkurtër dhe njëherësh poet të madh, që erdhi të vdiste në  
atë qytezë të madhe në jug të Francës (ku e kisha ftuar)

*mënyrët e vdekjes janë të ndryshme  
njëri vdes e tjetri ngordh*

*dallimi është se nganjëherë coftina  
jeton më gjatë në kujtesë*

*ruajuni pranisë së saj  
në fund të fundit më mirë  
të zgjidhni vdekjen tuaj*

*guximi shpërblehet me përjetësi<sup>1</sup>*

për të cilin kam shkruar një Requiem që dëshiroj ta interpretoj në këtë  
qytet të vogël të Rahovecit, ku kësaj rradhe jam unë ai që jam ftuar si  
një i pranishëm që mbart në vetvete gjatë gjithë kësaj kohe (tre vjet  
kanë kaluar tashmë nën urën e supeve tanë të lodhur). Është disi sikur  
t'i vija për vizitë një pjese të largët të familjes time, ku edhe pse nuk  
njoh askënd, unë gjej një ndjesi familjare: në një vend të huaj ajo që  
ne na dallon është pikërisht ajo që na bashkon. Ne të gjithë jemi të  
njëllojtë në veçantitë tona. Dhe avulli i bardhë që del nga kazani  
gjigantesk dhe i betontë i një çentrali bërthamor nuk do më  
përgënjeshtrojë.

---

<sup>1</sup> Nga poezia e Ali Podrimes *Zgjidheni vdekjen tuaj*.

Sa më shumë hyjmë në këtë peizazh, aq më shumë pikëtakojmë dëshmi të asaj ç'ka ishte një luftë e vërtetë. Në buzë të rrugës, nga larg, një kurorë, apo dy, tri, të kapura skiç në një shtyllë druri: diku një buqetë lulesh në një vazo, apo dy-tri, të vendosura në formë rrethore apo katrore, rreth një mungese, një kujtesë e ngjashme. Nganjëherë një pllakë mermeri të zi, një stelë e veçantë e personale, apo një gur varri i ngritur ku duket një emër, dy data tmerrësisht të afërta, një fotografi. Nganjëherë një pankartë më e madhe se të tjerat, një homazh kolektiv për atë që mund t'i ngjasojë një masakre që ka ndodhur. Ndonjëherë, një monument i vërtetë, në këtë rast në qytete apo fshatra, gjithnjë me atë mermer të zi, gjurmët e të cilit nuk i gjen rreth e rrotull. Dhe shtëpitë gjithashtu, të gjitha ose pothuajse në ndërtim e sipër, ngritur me tulla të kuqe, çka çdo fshat e tregojnë si një lloj kantieri, ku përpara kanë grumbuj trungjesh të mëdhenj.

(a po afron dimri? - jashtë bën 30° nga mëngjesi në mbrëmje!).

Vend tullash, trungjesh.

Dhe vdekje.

Por jo trishtim

(buzëqeshjet dhe përkujdesjet e mëdha këtu janë të zakonëshme)

Rohavec.

30.000 banorë

1800 të vdekur.

*“njerëzit pa atdhe*

*i vret gjithkush*

*nuk i duhen kujt*

*njerëzit pa atdhe  
copë toke duan qiell  
hiç më shumë*

*dekën ta bëjnë diku*

*udhëve tek i harron Zoti  
t'i mbulojnë e muranat  
korbat t'ua trembin<sup>2</sup>*

Kaloj në këmbë përmes qytetit. Kaloj mes një fshati të madh. Ende tulla dhe trungje. Vajzat dhe djemtë dalin nga shkolla fillore e rajonit parisian. Ah, sikur të mos ishte ngado aroma e specave. Gazi shurdhues i tre motorëve më kalojnë tepër afër! Që nga porta e hapur e një berberi një buzëqeshje të madhe më përshëndet, pacienti i zhytur në karrigen e tij më shoqëron me një tundje koke. Në çdo pyetje që ti bën, të sqarojnë me nxitim.

Ankth i të braktisurve? Në kafenenë e madhe në taracën e Park Hotel Plaza, kamarieri vegjetarian më shtrëngon dorën përzemërsisht me një mirëkuptim të heshtur. Birra e vendit, (Peja, 1 euro) është e këndëshme në qiellzën time të vetmuar, ndërkohë që nata bie mbi çadrat e diellit. Jemi aq pak klientë, humbur në rreth dyzetë tavolina, sa që curili i shatërvanit në mes mbush ndërkohë hapësirën me murmurimën e tij të herëpashërëshme. Pres grupin e vogël të poetëve që si dhe unë janë të ftuar në këtë festival të parë ndërkombëtar të poezisë.

---

<sup>2</sup> Nga poezia e Ali Podrimes *Apatridët*.

Bloku im i shënimeve bluan frutat e padurimit tim të paqtë...

Fjalët që ecnin mbi det  
një ditë nuk prekën më tokë  
humbën në det dhe që atëherë  
atje në fund  
pushojnë  
si vegla të ndryshkur e të vjetër  
janë kujtesa e fshehur e shtretërve tanë  
ku digjeshin ëndërrat tona të pamundura.

*(ah, deti është vdekja e mërmëritur njëmijë herë)*

dhe që atëherë  
ata presin  
fjalët  
që batica e ujrave nxjerr si avull  
për të gjetur më në fund kuptimin e vjetër  
dhe për të shndritur në shkëlqimin e koralit të agimeve  
në fletën e pastërt të një heshtje kripe

Hyjmë në xhaminë e madhe si në një sallon të veçantë. Për mirësjellje por dhe për respekt, heqim këpucët. Një ngrohje elektrike në cep të hyrjes. Ballë «mihrab»-it, një pendul i madh, i vjetër prej bakri që tundet e vret me përtesë kohën në çdo rrahje të rëndë të tij.

E vjetër prej pesë shekujsh, mbrojtja e xhamisë që nga vitet '70 sigurohet nga qeveria. Përgjegjësi i saj na ul rreth e rrotull pranë tij: na shërbehet rrush dhe çaj me shumicë. Një mësim i vogël sufizmi...

Trie shekuj e gjysmë më parë një i kreshter u ftua në një ceremoni syneti.

(në xhepin e tij bie zilja e telefonit).

Duke falenderuar, ai i dhuroi sektit sufi një shandan metali me krahë.

(ai e mban në duart e tij të holla e të bukura, sikur të ishte një amator kureshtar në pazarin e gjërave të vjetra)

Gjatë luftës, dhe kjo duhej të kishte ndodhur në vitin 1998, ushtria serbe e pushtoi këtë vend ku ishin strehuar dhjetra banorë. Ata kërkonin "Shandanin e Artë". "Ja ku është, - u kishte thënë miku që na priti, - është prej një metali të rëndomtë, por vlera e tij është tepër e çmuar për zemrat tona.

Pastaj ata na servirën çaj dhe fruta. «Meqë jam mes jush, do të thotë se mbeta gjallë», tha ai. Një buzëqeshje e lehtë u dallua nën mustaqen e tij gjysmë të zbardhur.

Por ja, lutja e xhamisë na bën të çohemi. Askush nuk lutet në sallën e madhe të pushtuar nga zhurmat nervoze të aparateve fotografikë numerikë.

Gjatë qëndrimit tim nuk pashë veç një grua në moshë mesatare që mbante një shami e cila ishte e shoqëruar nga një burrë që kishte në kokë një qeleshe të bardhë tradicionale në formën e një bombe.

Disa qindra metra nga xhamia, gjejmë freskinë shpëtimtare të një qilari gjigand me verë: «Stone Castle». Një nga tri më të mëdhatë e Europës, të thonë këtu. Vera kabërnë, e kuqe dhe e bardhë, shoqërohet me plot

copa djathi nga qumështi i deles dhe «jambon»<sup>3</sup> i thatë dhe i prerë hollë.

Islami këtu ka një shpirt mjaft të gëzueshëm e miqësor.

Shkojmë kështu gjithnjë e më thellë në burimin e pikëtakimeve tona. Në burimin e lumit Drin. Ujrat e pastra kristal që vijnë nga një rënie e njëpasnjëshme midis gurëve dhe pemëve, na zbulojnë origjinën e tij në misterin e ndrojtur të atij gjelbërimi. Nuk ka një burim të vetëm por një sërë rrjedhash të vogla që shfaqen nga nëntoka. Çdo lum këtu është një pikëtakim i një pafundësie rrjedhjesh nëntokësore. Unë jam një lumë i vetëm - në imazhin e gjithë lumenjve. Meqë në këmbët e mia uji i rrjedhshëm sjell lloj-lloj mbeturinash (në pjesën më të madhe shishe plastike) rreth meje pikas shumë gjëra të pista. Duke vazhduar fjalën nganjëherë lodhem në përpjekjen për një pastrim më të madh. Sigurisht, deti është larg. Por deti po afrohet.

Ulur mbi një shkëmb, me lapsin në dorë, unë ngadalësoj kohën që rreh brenda arterieve të mia.

Nëse ti kërkon detin

këtu

në këtë vend

ti nuk do ta gjesh në gjeografi

por në refleksët gri-blu të syve të burrave dhe grave

në rrjedhshmërinë e dritës së mëngjesit

në dallgëzimin origjinal të kodrinave

në valëzimin e gjelbërt të vreshtave

dhe në vërtitjen sufi ikur nga oborret e padukëshme

(Pikërisht në botën e imagjinare deti krijon horizontet e tij)

---

<sup>3</sup> Fletë mishi e prerë hollë.

Nëse ti kërkon detin  
këtu  
në këtë vend  
ti s'do ta gjesh te kujtesa  
ajo ka ikur një dite dhune dhe vrasje  
për të mos lënë në faqen e tokës së trishtuar  
veç firmën e zbehtë me kripën e lotëve të tij.

Rahovec (Kosovë) - Fecamp (Francë), shtator 2015

## Poeti i njohur francez, në një rrëfim për miqësinë me poetin shqiptar dhe kujtimet për Louis Aragon



LUAN RAMA

Takohemi në një kafene në "Goutte d'Or", në një lagje pranë Montmartre të Parisit, diku pranë shtëpisë së tij, në një kafene të rrethuar nga librat. Marc Delouze është një punëtor i poezisë, një dashnor dhe një animator i poezisë, pra që i jep asaj frymë, pasi krahas këngëve të tij poetike, ai është dhe organizator festivalesh, si Festivali i Përhershëm Poetik i Parisit 18, i Festivalit "Les Parvis Poétiques" ("Pragjet poetike") apo i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Zëri i Mesdheut" të Lodevës, në jug të Francës, ku më 1990-n ai ishte bashkëthemelues i tij dhe ku përgjatë shumë viteve në këtë festival u ftuan shumë poetë shqiptarë, të cilët

*Ai uli kokën dhe e mori mes dy duarve, ndërsa unë mendoja për qiellin e Podrimes dhe tokën e tij që nuk e mbante më...*

# Marc Delouze dhe orët e fundit me Ali Podrimen

Në faqen e parë lexoj emrin tim ..."

Në parathënien e botimit të librit të parë poetik të Delouze, shkruar nga Aragon, me titullin "Si një lloj testamenti", poeti i madh e paraqet Delouze si një shprehje të testamentit të tij poetik. Jo si një vazhdues i veprës së tij, por si një e ardhme e poezisë pas tij. Aragon shkruante mes të tjerash: "Në shtëpi kam një grup librash kryesorë, që i marr në duar me një emocion të veçantë ... një nga ata dhe libri i Marc Delouze, emrin e të cilit duhet ta mësoni ashtu siç dikur mësonim emrat e Nerval e të Rimbaud. Ah, ju lutem, mos më thoni se po e ekzagjeroj! A nuk e kuptoni se i dua këto poezi dhe ai që do, nuk ekzagjeron kurrë! ... Ky zë i ri që dëgjoj të

*Fjalët e tij tashmë shtegtonin nëpër qiell ... Marc Delouze ishte kthyer nga Kosova, ku kishte lexuar poezitë e tij për Podrimen*

janë njëkohësisht miqtë e tij. Ne u takuam meqë ai më kishte kërkuar përkthimin e një teksti për Ali Podrimen dhe unë ia solla, një tekst për mikun intim të tij. Ali Podrimja jetonte ende në shtëpi të tij, dhe në zemër, ngjizur. "E kisha vëllam të poezisë!" - më thotë ai, duke më treguar historinë e ditëve të fundit të poetit të madh të Kosovës në Lode, kur për ditë me radhë ai e kishte kërkuar derisa më në fund, katër ditë më vonë, e kishin gjetur në një shpat me sytë nga qielli. "Donte të shkonte!" - më tha ai. - "Ku? Në qiell?" - i thashë unë. Ai uli kokën dhe e mori mes dy duarve, ndërsa unë mendoja për qiellin e Podrimes dhe tokën e tij që nuk e mbante më, për tokën mbi të cilën ai nuk mund të ecte më, pasi ai jetonte në dhembje, prandaj dhe kërkonte qiell, diku larg, larg dhembjes, për të qetuar shpirtin. Fjalët e tij tashmë shtegtonin nëpër qiell ... Marc Delouze ishte kthyer nga Kosova, ku kishte lexuar poezitë e tij për Podrimen. I dhashë përkthimin e atij teksti në shqip, ndërsa ai më dhuroi një nga vëllimet e tij poetike "Epouvantails" (Dordolecët, 2002), duke më treguar njëkohësisht për jetën e tij, për vëllimin e tij të parë poetik, njohjen me poetin e madh Louis Aragon, dhe pastaj për ditën kur ai papritur, i nxori librat poetikë jashtë shtëpisë, në rrugë, duke i mbyllur portat e poezisë meqë dyshonte nëse ishte një poet i vërtetë ... porta që do t'i hapte 20 vjet më vonë ... E ndërkohë ne kujtonim hapat e parë, të botuar në një nga vëllimet e fundit poetikë.



"Janar i vitit 1971. Në mbrëmje bie telefoni.  
- Mirëmbërë, jam Louis Aragon. Dëshiroj të flas me Marc Delouze.  
- Unë jam ...  
Në fillim mendova se mos ishte një shaka. Isha gati të shpërtheja me të qeshura.  
- I mora poezitë e tua. Doja t'u merrja leje për t'i botuar në numrin e ardhshëm të revistës



*Ali Podrimja jetonte ende në shtëpi të tij, dhe në zemër, ngjizur. "E kisha vëllam të poezisë!" - më thotë ai, duke më treguar historinë e ditëve të fundit të poetit të madh të Kosovës në Lode*

*Les Lettres Françaises.*  
Përgjigjem:  
- Sigurisht, patjetër ...  
Nuk e di si e mbylla telefonin. Vështrova nga S.  
- Ishte Aragon! ...  
E pabesueshme. Isha në një gjendje të jashtëzakonshme. Një javë e kaluar si në mjegull, kujtesë.  
Të mërkurën që erdhi bleva revistën *Les Lettres Françaises*.

lartësohet, të forcohet dhe të triumfojë në sajë të vetvetes, ky libër i parë, mbetet gjithnjë para syve të mi si diçka prekëse, pas kësaj jete të gjatë të jetuar ... Diçka tjetër fillon këtu, diçka që unë nuk do ia shikoj fundin, por që nxitoj ta paralajmëroj me forcat e fundit të moshës sime ...". Më 17 shkurt 1970, Delouze shkruante një lloj kredeje të tij poetike:

*"Jam poet nga forca e gjërave nga forca e fjalëve, dora jonë mbi gjërat nga forca e lidhjeve për çdo fjalë një dorë shumë gjëra shfaq pëllëmba jonë dhe sekretet e saj shkruhen në statuja si buda enigmatike nga teoria në teori thoi e ka të vështirë të shënojë si vraga e kohës që kalon dhe më kërcënon me shkarjen e fjalëve si brishtësia e një letre të përdorur tashmë ..."*

Sigurisht, mund të flasim gjatë për Delouze, për vëllimet e tij poetike (*Kënga e tokave, 14975 ditë midis poezive në fazë përfundimtare, Yeou - këmbësori i tokave* etj.) dhe ato me tregime (*Është bota që flet, Rruga e martirëve, Njeriu që mbyllte sytë pa ulur qepallat* etj.), por ne u takuam atë ditë për Podrimen dhe fjalët e tij, madhësitë e fjalës poetike dhe vështrimin e tij të humbur në qiell, larg njerëzve, që tashmë e imagjinoj shpesh: Si mund të vdesë kështu një poet? - pyes unë ... E megjithatë u ktheva me idenë se poetët nuk vdesin...